

Data 27.07.2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës – Procedurë e hapur e thjeshtuar - Mallra - Prokurim me mjete elektronike

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Blerje dyer të brendshme për institucionin ARRSH Qendër”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Dyer 44221200-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,809,939.89 (dy milion e tetëqind e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë pikë tetëdhjetë e nëntë) **Lekë pa TVSH.**

Në bazë të Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024 Autoriteti/Enti Kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Buxhetin e Shtetit për shpenzimet kapitale për vitet 2026-2028 (Shkresa e MIE Nr. 2741/3 prot, datë 15.04.2026).

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar në DST paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Sigurimit të Ofertës, Formularit të Ofertës dhe Listës së Çmimeve sipas shtojcave përkatëse të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Megjithëse Formulari i Ofertës dhe Lista e Çmimeve janë pjesë përbërëse e DST-ve, përfshirja e tyre në këtë pikë është bërë për qëllime qartësie, transparence dhe administrimi korrekt të procedurës, me synim evidentimin e dokumenteve kryesore që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë në momentin e dorëzimit të ofertës.

Kjo mënyrë formulimi nuk shton kërkesa të reja kualifikimi dhe nuk krijon barriera për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, por shërben vetëm për të rikujtuar detyrimin për paraqitjen e dokumenteve të domosdoshme që garantojnë vlefshmërinë, krahasueshmërinë dhe vlerësimin korrekt të ofertave.

Përvoja e Autoritetit Kontraktor në administrimin e procedurave të prokurimit ka evidentuar raste të mosparaqitjes ose paraqitjes së paplotë të këtyre dokumenteve nga operatorët ekonomikë, çka ka sjellë vështirësi në procesin e vlerësimit të ofertave.

Për këtë arsye, evidentimi i tyre në mënyrë të veçantë synon vetëm garantimin e paraqitjes së plotë të dokumentacionit të ofertës dhe zhvillimin normal të procedurës së prokurimit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: sipas Shtojcës 9

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e kapacitetit profesional sipas Shtojcës 9 është përcaktuar në mbështetje të Nenit 77, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe Nenit 41, pika 4 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Përmes Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, operatori ekonomik deklaron përmbushjen e kërkesave që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë profesionale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Kjo kërkesë i shërben verifikimit paraprak të aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë për të ushtruar ligjërisht aktivitetin objekt prokurimi dhe është në përputhje me natyrën e kontratës dhe kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga këto vite duhet të jetë jo më e vogël se **40% e vlerës së fondit limit**.

Argumentimi:

Kërkesa për kapacitet ekonomik dhe financiar vendoset me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë një qëndrueshmëri financiare minimale dhe kapacitet për të përballuar realizimin e kontratës, duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, i cili përfshin furnizimin e dyerve, transportin, heqjen e elementeve ekzistuese dhe montimin e produkteve të reja.

Kërkesa që xhiroja vjetore në të paktën një vit të periudhës së kërkuar të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit konsiderohet proporcionale me vlerën dhe objektin e kontratës, pasi nuk vendos një barrë të tepruar mbi operatorët ekonomikë, por garanton që operatori ekonomik disponon kapacitetin e nevojshëm financiar për të realizuar detyrimet kontraktuale.

Ky kriter nuk synon të kufizojë konkurrencën, por të sigurojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që kanë një aktivitet ekonomik të konsoliduar dhe aftësi për të përmbushur kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale.

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë totale jo më të vogël se **20% e vlerës së fondit limit**.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të operatorit ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtëm:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar për ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës; ose
- Fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të evidentohen datat, vlerat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar për subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të evidentohen datat, vlerat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e dëshmive për furnizime të mëparshme të ngjashme vendoset me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë se operatori ekonomik ka **eksperiencën e nevojshme profesionale dhe kapacitetin teknik për realizimin me sukses të kontratës**.

Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin furnizimin e dyerve të brendshme dhe të blinduara, si dhe shërbime të lidhura me transportin, heqjen e dyerve ekzistuese dhe montimin e produkteve të reja, kërkohet që operatorët ekonomikë të kenë realizuar më parë furnizime me natyrë të ngjashme.

Vlera minimale prej **20% të fondit limit** është përcaktuar si një nivel proporcional dhe i arsyeshëm, i cili siguron që operatori ekonomik ka eksperiencë konkrete në këtë fushë, pa krijuar kufizime të panevojshme për konkurrencën.

Kriteri lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe synon të reduktojë riskun e mosrealizimit të saj, duke garantuar që operatori ekonomik i përzgjedhur ka aftësi të provuara për furnizimin dhe realizimin e detyrimeve kontraktuale.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë, broshura, skeda teknike ose dokumentacion tjetër teknik të lëshuar nga prodhuesi i mallrave të ofruara, ku të pasqyrohen karakteristikat dhe specifikimet teknike të produkteve objekt prokurimi.

Operatori ekonomik duhet të evidentojë në dokumentacionin teknik të paraqitur artikujt e ofruar dhe specifikimet teknike përkatëse, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me kërkesat e përcaktuara në **Shtojcën 6 – Formulari i Specifikimeve Teknike**.

Në rast se dokumentacioni teknik është në gjuhë të huaj, ai duhet të shoqërohet me përkthimin përkatës në gjuhën shqipe të pjesëve që lidhen me karakteristikat dhe specifikimet teknike të mallrave të ofruara.

Argumentimi:

Ky kriter vendoset me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë përputhshmërinë e mallrave të ofruara me kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin furnizimin e dyerve të brendshme dhe dyerve të blinduara, paraqitja e dokumentacionit teknik të prodhuesit ose ekuivalent siguron identifikimin e karakteristikave të produkteve (materialet, përmasat, përbërësit, aksesoret dhe parametrat e tjerë teknikë), duke garantuar që mallrat e furnizuara plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës, si më poshtë:

a) Të paktën **1 (një) punonjës montues dyersh/mobilier/marangoz**, i cili do të angazhohet për montimin dhe vendosjen e dyerve objekt prokurimi.

Disponueshmëria e këtij punonjësi të vërtetohet me kontratë individuale pune të vlefshme ose kontratë angazhimi, sipas legjislacionit në fuqi; dokument që provon kualifikimin profesional ose eksperiencën në këtë fushë (diplomë, certifikatë kualifikimi profesional ose dokument tjetër i barasvlershëm).

b) Të paktën **2 (dy) punonjës ndihmës**, të cilët do të angazhohen për transportin, shkarkimin, çmontimin e dyerve ekzistuese dhe ndihmën gjatë montimit të dyerve të reja.

Disponueshmëria e tyre të vërtetohet me kontratë individuale pune të vlefshme ose kontratë angazhimi, sipas legjislacionit në fuqi.

Shënim:

Kriteri 2.3.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit të Vetëdeklarimit (Shtojca 9). Dokumentacioni provues do të paraqitet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesa për disponimin e personelit teknik është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, i cili përfshin jo vetëm furnizimin e dyerve, por edhe veprimtari të lidhura me realizimin e plotë të kontratës, si transporti, heqja e dyerve ekzistuese dhe montimi i dyerve të reja.

Disponimi i një punonjësi me njohuri profesionale për montimin e dyerve dhe i punonjësve ndihmës është i nevojshëm për garantimin e realizimit korrekt të punimeve të montimit, ruajtjen e cilësisë së instalimit dhe dorëzimin e objektit në gjendje funksionale.

Ky kriter është proporcional me objektin e kontratës, pasi kërkon vetëm numrin minimal të personelit të nevojshëm për kryerjen e shërbimeve të parashikuara dhe nuk kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë të vlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente, si më poshtë:

- SSH EN ISO 9001:2015 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalente, e vlefshme në datën e hapjes së procedurës së prokurimit.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës **SSH EN ISO 9001:2015 ose ekuivalente** vendoset me qëllim garantimin që operatori ekonomik disponon një sistem të dokumentuar të menaxhimit të cilësisë për organizimin e proceseve të tij, kontrollin e furnizimeve dhe sigurimin e përputhshmërisë së mallrave të ofruara me kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin furnizimin e dyerve të brendshme dhe dyerve të blinduara, si dhe shërbime të lidhura me montimin dhe dorëzimin e tyre në gjendje funksionale, kërkohet që operatori ekonomik të ketë një sistem të përshtatshëm për menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë së realizimit të kontratës.

Ky kriter është proporcional me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi pranohet edhe certifikata ekuivalente e lëshuar nga organizma të njohur të vlerësimit të konformitetit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të realizojë transportin, shkarkimin dhe montimin e mallrave objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, duke përfshirë çmontimin dhe largimin e dyerve ekzistuese, si dhe furnizimin dhe vendosjen e dyerve të reja, në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Argumentimi:

Ky kriter përcaktohet duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, i cili përfshin jo vetëm furnizimin e dyerve të brendshme dhe dyerve të blinduara, por edhe shërbime të lidhura me realizimin e plotë të kontratës, si transporti, shkarkimi, çmontimi i dyerve ekzistuese, largimi i tyre dhe montimi i dyerve të reja.

Kërkesa për deklaratë siguron që operatori ekonomik merr përsipër realizimin e të gjitha fazave të parashikuara në objektin e kontratës dhe garanton dorëzimin e mallrave të furnizuara në gjendje të plotë funksionale, sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të ofrojë garanci për mallrat objekt prokurimi dhe montimin e tyre për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet, duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të tyre nga Autoriteti Kontraktor.

Gjatë periudhës së garancisë, operatori ekonomik merr përsipër të kryejë, pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor, riparimin ose zëvendësimin e çdo dëre, aksesori ose elementi përbërës që rezulton me defekt si pasojë e materialeve, prodhimit ose montimit jo të rregullt.

Operatori ekonomik duhet të ndërhyjë për verifikimin dhe riparimin e defektit brenda një afati maksimal prej 10 (dhjetë) ditësh pune nga data e njoftimit nga Autoriteti Kontraktor. Në rast se defekti nuk mund të riparohet, operatori ekonomik duhet të zëvendësojë produktin me një tjetër me karakteristika të njëjta ose më të mira, pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Gjatë periudhës së garancisë, operatori ekonomik do të mbulojë të gjitha shpenzimet që lidhen me transportin, materialet, pjesët përbërëse, punën e montimit dhe çdo shërbim tjetër të nevojshëm për rikthimin e produktit në gjendje të plotë funksionale.

Argumentimi:

Ky kriter vendoset duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, i cili përfshin furnizimin e dyerve të brendshme dhe dyerve të blinduara, si dhe montimin e tyre në ambientet e Autoritetit Kontraktor.

Kërkesa për një periudhë minimale garancie prej 2 vitesh synon të sigurojë që mallrat e furnizuara dhe shërbimet e montimit të jenë në përputhje me kërkesat teknike dhe të funksionojnë normalisht pas dorëzimit.

Afati i ndërhyrjes prej 10 ditësh pune është përcaktuar për të garantuar reagim në kohë ndaj problematikave që mund të lindin gjatë periudhës së garancisë dhe për të shmangur ndërprerjen e funksionimit normal të ambienteve të institucionit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës garanton se mallrat objekt prokurimi janë të reja, të papërdorura, të prodhuara në përputhje me standardet përkatëse të cilësisë dhe do të furnizohen të kompletuara me të gjithë elementët dhe aksesoret e nevojshëm për montim dhe funksionim të plotë, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Argumentimi:

Ky kriter vendoset me qëllim që Autoriteti Kontraktor të garantojë se produktet e ofruara janë mallra të reja dhe të papërdorura, të cilat përmbushin kërkesat teknike dhe cilësore të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin furnizimin e dyerve të brendshme dhe dyerve të blinduara, të cilat do të montohen në ambientet e institucionit, është e nevojshme që ato të dorëzohen të plota, së bashku me aksesoret përkatës, në mënyrë që të sigurohet instalimi dhe funksionimi i tyre korrekt.

Ky kriter është proporcional me objektin e kontratës, pasi nuk kërkon dokumentacion shtesë të panevojshëm, por vetëm një deklaram nga operatori ekonomik për cilësinë, gjendjen dhe kompletimin e mallrave të ofruara.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit, me qëllim sigurimin e furnizimit me produkte cilësore, funksionale dhe të përshtatshme për përdorim në ambientet e Autoritetit Kontraktor.

Kërkesat teknike janë përcaktuar duke marrë në konsideratë nevojën për zëvendësimin e dyerve ekzistuese me dyer të reja, të cilat duhet të garantojnë qëndrueshmëri, jetëgjatësi, funksionalitet dhe estetikë të përshtatshme për ambiente institucionale.

Karakteristikat teknike që lidhen me tipin e derës, trashësinë e fletës, strukturën e brendshme, materialin e kasës, veshjen sipërfaqësore, rezistencën ndaj konsumimit dhe lagështisë, aksesorët përbërës, guarnicionet, dimensionet, mënyrën e hapjes, ngjyrën, si dhe kërkesat për transportin, montimin, rregullimin përfundimtar dhe pastrimin pas montimit, janë përcaktuar si kërkesa minimale të domosdoshme për të garantuar realizimin cilësor të kontratës dhe funksionimin normal të dyerve gjatë përdorimit.

Kërkesa për garanci minimale **24 (njëzet e katër) muaj** është vendosur për të garantuar cilësinë e mallrave dhe të montimit, si dhe për të siguruar ndërhyrjen e operatorit ekonomik në rast të shfaqjes së defekteve gjatë periudhës së garancisë.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit teknik të produktit (Deklaratë Performance, sipas standardit të zbatueshëm, ose dokument ekuivalent) është vendosur për t'i mundësuar Autoritetit Kontraktor verifikimin e përputhshmërisë së produkteve të ofruara me specifikimet teknike dhe standardet e cilësisë të kërkuara.

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që të mos favorizojnë apo kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë. Referimet ndaj materialeve, standardeve ose karakteristikave teknike janë bërë vetëm për të përcaktuar nivelin minimal të cilësisë së kërkuar dhe duhet të kuptohen gjithmonë të shoqëruara me shprehjen "**ose ekuivalente**", në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.